



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR**

Nr. 18822 Prot

Shkodër, më 20/04 /2026

Lënda: Dërgohet për shqyrtim relacioni dhe projekt vendimi për miratim: *Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi, të pasurisë me nr. 316, vol 6, fq 48 zik 1209 nga pronar shtetin tek Bashkia Shkodër.*

KESHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë, Referuar ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, VKB nr. 60, datë 28,12,2020, "Për miratimin e rregullores të organizimit dhe funksionimit të Keshillit bashkiak Shkodër", bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacionin dhe projekt vendimin për miratim: *Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi, të pasurisë me nr. 316, vol 6, fq 48 zik 1209 nga pronar shtetin tek Bashkia Shkodër.*

Bashkëlidhur gjeni :

Projekt Vendim dhe Relacion .

Kopje kartele dhe plan rilevim .

Kërkesë për transferim .

Duke Ju uruar punë të mbarë!

ME VENDIM DELEGIMI

**ZV/KRYETAR
Alban PREKA**



KRYETAR

Benet BECI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____/2026

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, TË PASURISË
ME NR.316, VOL 6, FQ 48 ZK 1209 NGA PRONAR SHTETIN TEK BASHKIA
SHKODËR.

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës, _____.____/2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1.2, të ligjit nr. 139, datë, 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" të ndryshuar; nenit 3, pika a, nenit 5, nenit 17 të ligjit Nr.8744, datë 22.02.2001 "Per transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesite e qeverisjes vendore", të ndryshuar, VKM Nr.500, datë 14.08.2001 " Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njesite e qeverisjes vendore ", të ndryshuar; Udhëzimit Nr.15, datë 30.06.2003 "Për menyrën e paraqitjes nga njesite e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike, dhe sipas relacionit të paraqitur nga administrata e bashkisë Shkodër:

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Shkodër të pasurisë me këto të dhëna:
 - Pasuria nr.316, vol 48, Zona Kadastrale nr.1209 Shkodër me sipërfaqe totale 1959910 m², pasuri e cila rezulton me pronar shtetin referuar kartelës së pasurisë.
2. Fusha e përdorimit për këtë pasuri që kërkohet të tranferohen, do të jetë prona të cilat përdoren për kryerjen e funksioneve kulturore - sportive.
3. Të ndiqen procedurat përkatëse sipas legjislacionin në fuqi, pas miratimit të kërkesës nga Këshilli Bashkiak Shkodër për ndryshimin e pronësisë të pasurisë të sipërcituar duke bashkërenduar punën me institucionet përgjegjëse.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

Z/KRYETAR

Alban PREKA



Drejtoria Aseteve dhe Kadastres Urbane

Valdo DIBRA



Drejtoria Juridike

Brikena LEQEJZA



DREJTORIA E SPORTIT

Auron MILOTI



Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve

Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Griselda DAMA



Drejtoria e Përgjithshme

Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Mikel KAPSAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA E ASETEVE DHE KADASTRES URBANE

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.2026

RELACION

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, TË PASURISË
ME NR.316,VOL 6,FQ 48,ZK 1209 NGA PRONAR SHTETIN TEK BASHKIA
SHKODËR.

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Shkodër.

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Shkoder ka paraqitur materialin pranë Këshillit Bashkiak Shkoder, me objekt:

Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi, të pasurisë me nr.316, vol 6, fq 48, ZK 1209 nga pronar shtetin tek Bashkia Shkodër.

Kjo nisëm është ndërmarrë nisur nga kërkesa e paraqitur nga Drejtoria e Sportit ,e cila po bashkëpunon me Federatën Shqiptare të Futbollit me qëllim realizimin e investimeve në futboll pasi në vitin 2027 zhvillohet kampionati evropian i futbollit U-21 dhe Shqipëria është bashkëorganizatore e aktivitetit.

Shkodra është një nga qytetet mikëpritëse të këtij organizimi të rëndësishëm ,dhe për plotësimin e kushteve nga Bashkia Shkodër po punon për gjetjen e terreneve dhe fushave stervitore për ekipet pjesëmarrëse, fusha që me vone mbesin në shërbim të ekipeve të qytetit.

Nga verifikimet e kryara nga administrata e Bashkisë Shkodër në terren, pasuria me nr.316, vol 6, fq 48, ZK 1209 me sipërfaqe 1959910m² ndodhet pranë Varrezave të Dëshmoreve në Shkodër dhe plotëson kriteret për tu përdorur si terren sportiv,

Pasuria për të cilën kërkohet transferimi rezulton me pronar shtetin pa funksion përdorimi referuar karteles së pasurisë dhe nuk është përcaktuar zeri kadastral.

Fusha e përdorimit të kësaj pasurie do të jetë sipas përcaktimeve të nenit 3 , të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar,,do të jetë prona të cilat përdoren për kryerjen e funksioneve kulturore dhe sportive.

Ky propozim vjen edhe në vijim të bashkëpunimit institucional me insticionet të cilat kanë pronat nën përgjegjësi administrimi, referuar korrespondencës shkresore.

- Shkresë e Bashkisë Shkoder nr.18691 prot, datë 17.07.2026 me lëndë "Kërkesë për transferim prone drejtuar Drejtorisë së Pronës Shtetërore.

Vlerësojmë se ky propozim gjen mbështetje ligjore në dispozitat e ligjit nr.139, datë 17.12.2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Per transferimin e pronave të paluajtshme publike te shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar ,neni 3 ,nenit 5 ,dhe neni 17 ,VKM Nr.500, datë 14.08.2001 "Per inventarizimin e pronave te paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave ne njesite e qeverisjes vendore", i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr.15, datë 30.06.2003 "Per mënyren e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike".

Në zbatim të VKM nr.28, datë 27.1.2023 "Per përcaktimin e procedurave ë hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve " Kreu II, paraprakisht kërkon Vendimin e Keshillit Bashkiak dhe Ligjshmërinë nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër per trajtimin në vijim sipas procedurave të parashikuara me qëllim përfundimin e procedurave mbi transferimin e këtyre pasurive.

Sa me siper i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë propozimin: *Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi, të pasurisë me nr.316, vol 6, fq 48 zk 1209 nga pronar shtetin tek Bashkia Shkodër.*

Duke ju falenderuar!

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR

Alban PREKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA E ASETVE DHE KADASTRES URBANE**

Nr. 18691 Prot

Shkodër, më 17.7.2026

Lënda : Kërkesë për transferim.

DREJTORISË SË PRONAVE SHTETËRORE

Adresa: "Rruga Dora D'Istria" , Tiranë

Në vijim të zbatimit të procedurave përkatëse të Bashkisë Shkoder, ligjit nr.139/2015 "Për veteqeverisjen vendore i ndryshuar, ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", i ndryshuar , ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 11 , ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH", i ndryshuar, Bashkia Shkodër me qëllim realizimin e detyrave funksionale dhe për të qene sa më afër qytetarëve në ofrimin e shërbimeve, paraqet pranë institucionit tuaj kërkesën për transferimin e pasurisë nr.316 , vol 6, fq 48 me sipërfaqe 1959910 m², me vendodhje ZK nr.1209 Bleran Shkodër.

Pasuria e cila kërkohet rezulton me pronar shtet dhe për sa më sipër po ju drejtohem për vijimin e procedurës për transferimin e pronësisë me qëllim përdorimi në funksion të zhvillimit të aktiviteteve në fushën kulturore – sportive.


Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të një përgjigje pozitive nga ana Juaj!

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

**Z / KRYETAR
Alban PREKA**



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI : SHTET

DATE : 17 / 07 / 2026

QELIMI : RREGJISTRIM

VENDNDODHJA

BASHKIA : SHKODER

DVASHKZVASHK : SHKODER

ZONA KADASTRALE : 1209

NUMRI PASURISE : 316

INDEX HARTE : K-34-64/210-A,194-A,178-C

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE : XX

SIP PASURISE = 11969910 m2

SIP GJURMES NDERTIMIT =


NUMRI I KATEVE :

VL 6 FQ 48

X 461354.88
Y 4658045.76

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 461402.48
Y 4659130.76



SH:

ORIENTIMI	PERDORIMI	TIP I KUFI RT	KUFI TARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
VERI					
LINDJE					
JUGU					
PERENDIMI					

DREJTORIA ASETIVE DHE KADASTRES URBANE

DREJTORI: VALDO DIBRA

PUNOI SPECIALISTI : ARIJAN VASUA

ZV/KRYETAR

ZYKALBAN PREKA

NENSHKRIMI / VULA

REALIZOI PER ASHK

DVASHK

SPECIALISTI

NENSHKRIMI

KONFIRMOI

PERGJEGJESJI / DREJTORI

NENSHKRIMI / VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:

Kode per teknologjine e matjeve: T-Tereni; z-zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-matje Distanca sh;

PERCAKTIMI I KUFI RT:

Kode per percaktimin e kufi rt: P-Perfaqesues i Pronave ; K-Kufi taret te Gjithne ; KP-Kufi taret Pjeserisht ; PB-Perfaqesues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

PROMARI / BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MAREDHENIET ME KUFI TARET

EMRI : BASHKIA SHKODER

NENSHKRIMI

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufi rt: T-Tereni; z-zyre;o-Ortofoto;G-GPS; S-Stacion Total; d-matje D-Matje Distanca sh; p-Perfaqesues i Pronave; k-kufi taret te Gjithne; KP-Kufi taret Pjeserisht; PB-Perfaqesues Bashkie, HK- Harta Kadastrale

Vol. 6, Fq. 48

A-SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TE PASURISE

Zona Kadastrale: 1209 NR. i PASURISE: 316

-> Vijn nga: Vol. _____, Fq. _____

Indeksi i Hartës: K - 34 - 64 - (210-A)

Vijon në: Vol. _____ Fq. _____ deri në Vol. _____ Fq. _____ -->

PERFUNDIMTARE (data): 04/02/2021

Adresa e pasurisë: Rrethi SHKODËR Q/F BLERAN

Rr/L _____ P/G _____ Sh _____ K _____ Ap _____

Pershkrim i Veçantë

B-SEKSIONI I PERSHKRIMIT TE PASURISE

Lloji I Pasurisë xxxx Brenda V.K.N. Jo --> Po, Ref: PL.RREG.

Sip. Totale e Pasurisë Nga Sip. Totale: sa Truall Nga Sip. Truall: sa Ndërtesë

1. _____ m² 1. _____ m² 1. _____ m²

Ref _____ Ref _____ Ref _____

1. 1959910 m² 1. m² 1. m²

Ref LN 2019 Ref _____ Ref _____

1. _____ m² 1. _____ m² 1. _____ m²

Ref _____ Ref _____ Ref _____

1. _____ m² 1. _____ m² 1. _____ m²

Ref _____ Ref _____ Ref _____

Për pjesën e përbashkët:

PALLAT.

Kuota e pjesëmarrjes:

%

Nr.i Pasurisë (Pallat):

Vol. _____ Fq. _____

C-SEKSIONI I PRONESISE

Nr Dok	Data Regjistrimit	Emri Atësia Mbiemri	Nr Pasp	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Çertifikatës	Shënime	Firma
LN 2019	07/08/2020	SHTËT		I					



Kerkese per gjtja hapesire per fushe futbollit

From Antonio Shabani <Antonio.Shabani@bashkiashkoder.gov.al>
Date Fri 17-Jul-26 10:04 AM
To Arban Gjoka <Arban.Gjoka@bashkiashkoder.gov.al>
Cc Auron Miloti <Auron.Miloti@bashkiashkoder.gov.al>; Valdo Dibra <Valdo.Dibra@bashkiashkoder.gov.al>; Alban Preka <Alban.Preka@bashkiashkoder.gov.al>

Të nderuar,

Drejtoria e Sportit, në vijim të përmbushjes së detyrave të saj funksionale për krijimin e kushteve optimale për zhvillimin e sportit në komunitet, si dhe në kuadër të përgatitjeve për zhvillimin e Kampionatit Evropian të Futbollit UEFA U-21, ju drejtohet me kërkesën për identifikimin e ambienteve sportive të përshtatshme për fusha futbollit në territorin e Bashkisë Shkodër.

Qëllimi i kësaj kërkesë është evidentimi i hapësirave që mund të përfshihen në një proces bashkëinvestimi ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Federatës Shqiptare të Futbollit, me synim përmirësimin e infrastrukturës sportive dhe krijimin e kushteve sa më cilësore për zhvillimin e aktiviteteve sportive dhe promovimin e futbollit.

Lutemi që, pas verifikimit nga ana juaj, të na përcillni informacionin mbi asetet ose hapësirat që vlerësohen të përshtatshme për këtë qëllim.

Duje Ju uruar punë te mbarë,

Antonio Shabani

Specialist Sporti
Drejtoria e Sportit
Tel: +355 69 738 4848
Web: www.bashkiashkoder.gov.al



Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privilegjuara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

The information transmitted in the content of this message is intended only for the individual or the institution to whom it is addressed, may contain confidential and/or privileged material for the recipient only. Each review, transmission, distribution or performance of any other action similar to these, by persons or by entities other than the intended recipient, is prohibited. If you receive this message in error, please contact the sender immediately and delete any transmitted material on your computer. We do not accept no liability related to damage or loss caused by harmful programs or viruses, except in the event of gross negligence, or willful misconduct